



Prof. Dr. Suzana Guxholli

Profesor

Zëvendës Rektore për Çështjet
Akademike

KONTAKTE

✉ rector@umb.edu.al



Prof. Dr. Suzana Guxholli

Profesor

Zëvendës Rektore për Çështjet
Akademike

BIOGRAFIA

Profesor dhe Doktor me një histori të pasur mbi 43 vjet, ne fushën e arsimit të lartë si brënda dhe jashtë vendit. Aftësi të shquara profesionale dhe individuale si aftësi analitike, drejtuese, folëse publike në disa gjuhë si shqip, anglisht, frëngjisht, italisht, rusisht, spanjisht etj, experiencë në konsulenca, këshillime e projekte zhvillimi kombëtare e ndërkombëtare në sektorin publik dhe privat brënda e jashtë vendit si në Itali, Hungari, Izrael, Maqedoni, Poloni, Slloveni, Turkmenistan, Kosovë, etj. Hartuese, drejtuese, e zbatuese e projekteve kombëtare e ndërkombëtare.

Ka fituar titullin akademik Prof. Dr. nga Universiteti i Tiranës dhe ka kryer gradën shkencore doktor i filozofisë në fushën kontabilitet e financës si dhe diplomë bachelor në kontabilitet e financë dhe master e bachelor në inxhinieri mekanike nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Inxhinierisë.

Ka kualifikime, trajnime dhe eksperiencia të shumta ndërkombëtare ku si më spikatëse janë: një ndër Fulbright-et e parë shqiptarë ne SHBA, kurse kualifikimi pasuniversitare ne ekonomi, financë e menaxhim, organizuar nga Banka Botërore, FMN, Kombet e Bashkuara - UNDP, Universiteti i Harvardit etj.

Autore, bashkëautore dhe publikuese e 7 librave e teksteve profesionalë, mbi 15 artikujve shkencorë (me disa recenca vlerësuese), edituese e manualit dhe e buletinit për karrieren dhe Alumni tek CEU, Budapest Hungari pr 8 vite, prezantuese dhe referuese në më shumë se 80 konferenca dhe forume ndërkombëtare dhe dhjetra të tjera kombëtare.

Keshilltare Ekonomike e Kryeministrit, lektore dhe drejtuese në Universitete private si UNYT, UET, dhe rishtazi universiteti "Barleti", Tiranë, zv.-rektore për kërkim dhe novacion, 2019-2021 e nga muaji maj 2021 - sot, Prof. Dr. Guxholli mban titullin rektore e Universitetit Barleti.